



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2020:164925

Datë: 05.03.2025

Numri i dokumentit: 06940500

C.nr.802/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtaren Lirika Sylaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Rr. F nga fshati D, Komuna e Istogut, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shqipdona Maraj – Ferizaj – avokate në Istog, kundër të paditurës Kompania K. N sh.p.k të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" sh.p.k me seli në lagjen Veternik, kompleksi banesor EXDC3, blloku 10, kati VI, nr.17&18 në Prishtinë, me avokat Taulant Hajdari, me objekt kontesti kompensim i demit dhe fitimit të humbur, në seancën gjyqësore të datës 05.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

- I. REFUZOHET NË TËRËSI si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Rr. F, me të cilën ka kërkuar " *që të obligohet e paditura Kompania K. që në emër të demit të shkaktuar, për shkak të fitimit të munguar dhe demit të ardhshëm prej datës së shkaktimit nga viti 2012 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, të paguaj shumën e kompensimit aq sa do të përcaktohet sipas ekspertizës , me kamatë ligjore nga data e shkaktimit të demit 2012 e në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyimit, nën kanosjen e përmbarimit të dhunshëm*".
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes përfaqësueses së autorizuar, me datën 25.11.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania K. me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensim i demit dhe fitimit të humbur, duke theksuar se lartësia e demit do të caktohet pas nxjerrjes së ekspertizave përkatëse.

Gjykata lidhur me këtë çështje e ka caktuar seancën përgatitore me datë 06.02.2025, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësuesit e palëve dhe të njëjtit e kanë informuar gjykatën se do të negociojnë pajtimin gjyqësor apo jashtëgjyqësor dhe se për këtë të njëjtit do të jenë koherent që ta njoftojnë me kohë gjykatën.

Gjykata me datë 04.03.2025, ka pranuar një parashtresë nga përfaqësuesja e paditësit, përmes të cilës e ka njoftuar gjykatën se me palën e paditur kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore sa i përket kësaj çështje, duke e njoftuar gjykatën se heqin dorë nga kërkesëpadia me bazë juridike kompensim dëmi pasi që tani më kanë pushuar shkaqet që kjo procedurë të vazhdoj.

Në një situatë të tillë, gjykata duke u bazuar në nenin 149 paragrafi 1 të LPK-së në të cilin përcaktohet se *“Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadiës apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”*, mori aktgjykim si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi me të cilin kërkesëpadia e paditësit është refuzuar në tërësi si e pabazuar.

Gjykata ka vendosur si në dispozitivin I, pa pasur nevojë ta ketë pëlqimin e të paditurit, kjo duke u bazuar në paragrafin 2, të nenit 149 të LPK-së, ku thuhet se *“Për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet pëlqimi i palës së paditur”*.

Vendimin si në dispozitivin II, të këtij aktgjykimi gjykata e ka marrë duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata në kuptim të nenit 160.6 të LPK-së, në arsyetimin e këtij aktgjykimi ka dhënë vetëm arsyet qe e justifikojnë marrjen e aktgjykimit për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadia.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

G j y q t a r j a
Lirika Sylaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Në kuptim të nenit 181, paragrafi 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo në ndikimin e dhunës apo mashtrimit.